



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve Përmes Likuidimit Nr.66

Njësia e Vendosur në Tender Nr.26

NSh DLB-Parcela 8956-0 ZK Prizren

Emri i NSh.-së

NSH "D.L.B Lavërtaria-Blegtoria" - Prizren në likuidim ("Ndërmarrja") (emrat e mëparshëm): PIK "Progres-Export"- "Ratarstvo" sa P.O Dusanovo, "Progres Export- Ratarstvo i Stocarstvo " Fi.-698/89, Fi.-7337/92).

Lloji i shitjes

Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.

Dita e Ofertimit

Më 26.06.2024 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.

Regjistrimi i Ofertuesit

Nuk ka parakualifikim

Depozita e Ofertës

5,000 Euro

Vendndodhja e Aseteve

Zona Kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit, Rajoni i Prizrenit

NSh DLB - Parcela 8956-0 ZK Prizren - ofron për shitje tokën bujqësore që ndodhet në Zonën Kadastrale Prizren dhe përfshin ngastrën kadastrale P-71813068-08956-0 me sipërfaqe prej **3530 m²** (arë kl.2) e regjistruar në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme.

Sipas vizitës në terren, kjo parcelë shtrihet në pjesën jugore të zonës kadastrale, pranë rrugës fushore, e në jug të rrugës nacionale Prizren-Kukës.

Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.

Përshkrimi i Aseteve

Vërejtje për pronën për ofertuesit e mundshëm:

Në pronën lëndë e shitjes, në Certifikatën e Pronës së paluajtshme nuk ka të regjistruar barrë tatimore.

Në kërkesën e AKP ZR Prizren lidhur me informatën për barrë tatimore (kërkesave të ZR Prizren) ATK është përgjigjur me shkresën e datës 19.01.2017, 24.01.2017, 15.09.2017 dhe 22.11.2018 se NSh-ja ka të vendosur barrë tatimore që nga data 03.12.2013. Në përgjigjen e datës 24.01.2017 nga ZQ ATK Prishtinë, përveç informative për barrë tatimore të vendosur është bashkangjitur edhe Konkluzioni nga ZKK Prizren i dt. 10.02.2014 përmes së cilës kërkohet nga ATK-ja që barra e vendosur tatimore në prone të DLB-se, të pezullohet përkohësisht. Gjithashtu, me dt.02.03.2017 është dërguar kërkesa në ATK-Prishtinë për rishqyrtim të barrës tatimore të vendosur në pronën e NSh-se, dhe me dt. 13.03.2017 është pranuar përgjigja nga ATK-ja ku ceket se vendosja e barres tatimore është bere me 03.12.2013 para fillit të likuidimit të NSh-se në fjale dhe se nuk është në kundërshtim me Ligjin 03/L-222, Udhëzimi administrativ 2010/15 dhe Memorandumit në mes ATK dhe AKP.

AKP ZR Prizren, nuk është njoftuar zyrtarisht nga ana e ATK-së as nga ana e ZKK-se mbi vendosjen respektivisht pezullimin e perkohshem të barrës

Ndërtesat dhe tokat



Shfrytëzuesit

Nuk ka.

Përshkrimi i Aseteve

Asetet tjera

Nuk ka.


Detyrimet që do të barten

Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje

PARCELA KADASTRALE 8956-0, ZK PRIZREN



Harta është shikuar nga gjeoportali më dt. 12/02/2024

AKP-ZQ, zyrtari kadastral: A.Luta

Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhena nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



Raporti i vizitës në terren



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Data: 12.02.2024

Raport nga vizita në terren-NSH- PIK“PROGRES”– Parcela 8956-0 zK Prizren

Më datën 09.02.2024 së bashku me zyrtarin kadastral Agron Luta, nga ZQ dhe zyrtarët nga ZR Prizren, Qamil Totaj dhe Nazmije Polloshka, kemi vizituar njësinë për shitje me llikuidim, parcelën 8956-0, Zona kadastrale Prizren, e cila evidentohet në emër të PIK “PROGRESI” në Prizren.

Kjo njësi për shitje përfshin parcelën 8956-0, me sipërfaqe prej 3530 m², me kulturë arë e klasës 2 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Prizren, e regjistruar në certifikatën e pronës të datës 24.01.2024.

Kjo parcele shtrihet në pjesën jugore të zonës kadastrale, pranë rrugës fushore, e në jug të rrugës nacionale Prizren-Kukës, zone kjo ku ekzistojnë ndërtime të shtëplve individuale dhe sipërfaqe bujqësore.

Gjatë vizitës në terren është konstatuar:

- Parcela është e papunuar- djerrinë.
- Nuk ka uzurpim apo ndërtim as ne afërsinë e saj.



Zyra Rajonale në Prizren
Rr. Pushkatarët nr. 9
20000 Prizren, Kosovë
Tel: +381 (0)29 226 480
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

1. Ismet Demolli
2. Agron Luta
Zyrtar Kadastral, AKP ZQ

1. Qamil Totaj
2. Nazmije Polloshka
Zyrtar i Operacioneve për Adm nstrim të Aseteve

1 / 1

Informatat

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +383 (0) 38 500 400 ext.1090,2059
Fax: +383 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.